

VENDIM
Nr.9, datë 21.2.2007

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIME TË RINOVUESHME**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2007, pasi shqyrtoi draftin për rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME**

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Këto rregulla hartohen në bazë të nenit 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr.9051, datë 3.4.2006, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 2
Qëllimi

Në funksion të zhvillimit dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve energjetike të rinovueshme, qëllimi i këtyre rregullave është të sigurojnë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilët paraqesin në ERE kërkesën për marrjen e certifikatës të garancisë së origjinës dhe/ose certifikatës së gjelbër.

Neni 3
Objekti

Këto rregulla përcaktojnë kriteret dhe procedurat për marrjen e certifikatës së garancisë së origjinës (GO) dhe certifikatës së gjelbër (CGJ).

Këto rregulla parashikojnë udhëzime teknike dhe procedurale për lëshimin nga ERE të GO-së dhe CGJ-së për prodhuesit që gjenerojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme.

Neni 4
Zbatimi

Këto rregulla do të zbatohen për certifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme, bazuar në procedurat e ERE-s.

Neni 5 Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Ligj" do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me të gjitha ndryshimet.

2. "Bordi i Komisionerëve" do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar

3. "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.

4. "I licencuar" do të thotë një person që mban një licencë të dhënë sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

5. Certifikimi do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe në veçanti të këtyre rregullave deri në finalizimin e procesit me dhënien e certifikatës së garancisë së origjinës dhe/ose certifikatës së gjelbër. Certifikimi kryhet sipas dy hapave vijues: 1. kualifikimi i impianteve prodhuese të energjisë elektrike; 2. lëshimi i certifikatave GO dhe/ose CGJ.

6. Kualifikimi i impianteve prodhuese të energjisë elektrike, d.m.th. të gjithë veprimet e ndërmarra nga ERE, me kërkesën e prodhuesit, për të verifikuar që impianti prodhues ka karakteristikat e nevojshme për të kërkuar në vijim GO dhe/ose CGJ lidhur me energjinë elektrike të prodhuar.

7. Certifikata e garancisë së origjinës (GO) është dokumenti i lëshuar nga ERE, që vërteton se energjia elektrike (totale/ose e pjesshme) e prodhuar nga një prodhues paraprakisht i kualifikuar vjen me të vërtetë nga burime të rinovueshme.

8. Certifikata e gjelbër është dokumenti i lëshuar nga ERE, i cili vërteton që sasia e energjisë (e plotë/pjesshme) e prodhuar nga prodhuesi paraprakisht i kualifikuar, është energji e rinovueshme e mund të tregtohet si e tillë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore. CGJ lëshohet nga ERE vetëm për energjinë e prodhuar nga një impiant prodhues i vënë në punë pas datës 2.11.2000.

9. Burime të energjisë së rinovueshme janë burimet e energjisë që prodhohen nga uji (hidro), era (eolike), dielli (solare), gjeotermale, lëvizje valore (dallgët), batica dhe zbatika, biomasa dhe biogazi.

10. Biomasa d.m.th. pjesa e biodegradueshme e produkteve, mjeteve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndët bimore, shtazore), pylltaria dhe industrinë e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.

11. Gjeotermale d.m.th. burimet gjeologjike natyrore të nxehtësisë së brendshme të tokës me origjinë reaksionet kimiko-fizike në shtresat përbërëse të saj.

12. Lëvizja valore d.m.th. lëvizja në formë kreshte ose valëzimi në sipërfaqen e oqeanëve, deteve dhe liqeneve e shkaktuar nga era dhe efektet gjeologjike dhe energjia e krijuar nga kjo lëvizje shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

13. Batica dhe zbatika d.m.th. ngritja dhe rënia e alternuar e sipërfaqes së oqeanëve, deteve, liqeneve, e cila ndodh dy herë në ditë dhe është rezultat i ndryshimit të forcave gravitacionale të ushtruara në pjesë të ndryshme të tokës nga një trup tjetër (dielli, hëna); energjia potenciale e kësaj lëvizje shfrytëzohet për prodhimin e energjisë.

14. Biogazi d.m.th. përzierja e gazit metan me dioksid karboni, e prodhuar nga dekompozimi bakterial i mbetjeve organike dhe që përdoret si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike.

15. Subjekti relatives do të thotë Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të ERE-s e ngarkuar për shqyrtimin e një kërkesë për kualifikim dhe certifikim.

16. Kërkesa do të thotë person fizik ose juridik, që kërkon të pajiset me certifikatën e garancisë së origjinës dhe/ose certifikatën e gjelbër.

17. Central prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme është një impiant që

prodhon energji nga burime të rinovueshme.

18. Prodhues hibrid është centrali elektrik, i cili konsumon të dyja llojet e burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme.

19. Korografia d.m.th. përshkrimi ose harta e një rajoni ose objekti, si dhe formimi fizik dhe përbërësit e këtij rajoni ose objekti.

20. Rezervë pompimi d.m.th. një sistem hidroelektrik, në të cilin energjia elektrike prodhohet gjatë periudhave të pikut të kërkesës nga përdorimi i ujit që është pompuar në një rezervuar në një lartësi më të madhe, gjatë periudhave jo të pikut, me kërkesë më të ulët për energji elektrike.

PJESA E DYTË PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT

Neni 6

Klasifikimi i centraleve të energjisë elektrike

Tipet e teknologjive prodhuese, të cilat mund të përfitojnë kualifikimin, janë përshkruar në tabelën 1.1.

Tabela 1.1. Klasifikimi i prodhuesve të energjisë të cilët gjenerojnë energji nga burime të rinovueshme

Tipi i implantit	Nëntipi i implantit	Burimi
Hidro	Rrjedhë lumi Rezervuar Basen Kanal derivacioni	Ujë
Era (eolike)	Të vendosur në det (onshore), në tokë (offshore)	Era
Gjeotermale	-	Energjia gjeotermale
Diellore (solare)	Fotovoltaike Fotovoltaike/termale	Energji diellore
Termale	Avulli Djegia brendshme Cikël i kombinuar Gazi Të tjera	Biomase***
		Biogaz
Hibrid* Bashkëdjegie** Të tjera	-	Burime konvencionale
	-	Burime të rinovueshme
Detare	-	Batica dhe zbatica
		Lëvizja valore (dallgët)

* Implantet hibride gjenerojnë energji elektrike nga përdorimi i të dyja burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme dhe përfshijnë implantet me bashkëdjegie.

** Bashkëdjegia përkufizohet si djegia njëkohësisht e lëndëve djegëse dhe trupave të ngurtë jo të rinovueshëm dhe lëndëve të lëngëta ose gazore të përfutuara nga burime të rinovueshme. Nëntipi i implantit është i njëjtë me atë të impianteve termale.

*** Biomasa d.m.th. pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndët bimore, shtazore), pylltaria dhe industrinë e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.

Neni 7

Kërkesat për kualifikimin e impianteve prodhuese

Prodhuesi, i cili dëshiron të marrë kualifikimin e implantit prodhues, paraqet në ERE një kërkesë specifike me shkrim, duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi

dhe ato të kërkuara nga kjo rregullore. Kualifikimi i një impianti prodhues kryhet vetëm një herë në të kundërt vetëm nëse janë kryer ndryshime të mëdha në impiante prodhuese të energjisë elektrike të kualifikuara më parë.

Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet gjithashtu për një central prodhues energjie të rinovueshme dhe në fazën e projektimit ose në fazën e ndërtimit.

Kërkesa për kualifikim përfshin:

- një raport teknik specifik, që përshkruan tipin e teknologjisë gjeneruese, siç përcaktohet në tabelën e sipërpërmendur në nenin 6.

- një dokument teknik, i cili përshkruan karakteristikat bazë të prodhuesit të energjisë, përfshirë anekset teknike nëse ka.

- projekti i zbatimit të centralit në rastet e kualifikimit të kërkuar për një prodhues energjie ende në projekt ose në ndërtim (projekti i ndërtimit, elektromekanik, lidhjes me sistemin etj., i cili paraqitet për marrjen e lejes së ndërtimit).

- çdo dokument tjetër të lëshuar, që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë.

Dokumenti teknik përmban:

1. përshkrimin e përgjithshëm të centralit:

a) burimet e energjisë (të rinovueshme ose jo);

b) tipin e centralit;

c) kapacitetin nominal që jepet nga shuma e kapacitetit nominal të turbinave ose agregatëve siç raportohet në targetat e secilit element;

d) prodhimin e pritshëm vjetor.

2. dokumentet vijuese grafike:

a) koreografia;

b) planimetria e përgjithshme;

c) skema funksionale;

d) skema elektrike, me qëllim identifikimin e matësve të gjenerimit të energjisë elektrike të certifikuar nga autoriteti publik kompetent.

3. përshkrimi i centralit duhet të jetë edhe më i detajuar për:

a) hidrocentralet që përdorin dhe rezerva pompimi, në mënyrë që të llogariten sasitë e energjisë së atribuar kësaj rezerve pompimi, mbasi kjo sasi energjie përjashtohet nga prodhimi që mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ;

b) centrale hibride të energjisë elektrike, pasi vetëm energjia e prodhuar nga lëndë me prejardhje nga burime të rinovueshme mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ;

c) centrale që djegin mbetje, me qëllim llogaritjen e pjesës së energjisë elektrike të prodhuar, që i atribuohet pjesës së biodegradueshme të mbetjeve, pasi vetëm kjo mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ.

Neni 8

Fillimi i procedurave të kualifikimit të prodhuesve

ERE, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të saj, merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës për kualifikim dhe cakton për çdo kërkesë subjektin relatues të çështjes, i cili është edhe pika e kontaktit të ERE me kërkuuesin. ERE mund të kërkojë çdo sqarim, si dhe të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për palët në proces.

Neni 9

Shqyrtimi i aplikimit për kualifikim

1. Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje, brenda 90 ditëve ERE shqyrton aplikimin dhe informon kërkuuesin për vendimin e Bordit mbi kualifikimin ose refuzimin e tij. Kualifikimi do të konsiderohet i kryer automatikisht nga ERE, në rast se asnjë komunikim nuk do t'i jepet kërkuarit brenda 90 ditëve të sipërpërmendura.

2. Brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Bordi i Komisionerëve merr vendim për:

- a) dhënien e kualifikimit të kërkuar, i cili regjistrohet në librin e kualifikimeve të ERE;
- b) refuzimin në rast se subjekti nuk përmbush kërkesat e nevojshme për t'u kualifikuar;
- c) pezullim.

3. Në çdo rast të vendimit për refuzim, ERE justifikon vendimin për refuzim. Kur ERE konstaton se kërkesa për kualifikim e paraqitur nga aplikuesi nuk përmban dokumente të rëndësishme që pengojnë ERE-n në verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregulloreje, ERE specifikon që dokumenti është jo i plotë.

4. ERE merr vendim për pezullim kur kërkesa nuk përmban disa dokumente të cilat pengojnë ERE-n për verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregulloreje. ERE i komunikon, kërkuarit brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, që shqyrtimi i kërkesës është pezulluar. ERE specifikon dokumentet që mungojnë ose janë jo të plota, të cilat duhet t'i paraqiten ERE-s brenda 60 ditëve në vijim. Në vijim të analizës së dokumentacionit shtesë kërkesa mund të pranohet ose refuzohet. Nëse dokumentacioni i munguar apo shtesë nuk dërgohet brenda 60 ditëve nga data e njoftimit nga ERE, kërkesa refuzohet për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. Në këtë rast kërkuari mund të paraqesë një kërkesë të re kualifikimi.

5. ERE, kur e sheh të nevojshme, mund t'u kërkojë çdo informacion organeve kompetente, duke informuar kërkuarin.

6. Në çdo rast të marrjes së vendimit nga Bordi për refuzimin e kualifikimit të kërkuar, aplikuesi mund të paraqesë një kërkesë të re duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

Neni 10

Lëshimi i garancive të origjinës (GO) dhe certifikatave të gjelbra (CGJ)

1. Prodhuesi mund të paraqesë kërkesë për marrjen e CGJ-së për sasinë e energjisë elektrike realisht të prodhuar, në bazë vjetore, nga centralet prodhuese të energjisë paraprakisht të kualifikuara, siç përshkruhet në nenin 7, 8 dhe 9 dhe pas vënies në punë të impiantit prodhues. Data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik duhet të jetë pas 2.11.2000. CGJ mund të tregtohen në tri vitet pasuese pas lëshimit të tyre.

CGJ lëshohen për:

- a) të gjithë prodhimin vjetor të energjisë elektrike nga hidrocentralet, përveç sasisë që i atribuohet rezervave të pompimit;
- b) të gjithë prodhimin vjetor të energjisë elektrike nga hidro (ujore), eolike (era), solare (diellore), gjeotermale, lëvizjen valore (dallgët), batica dhe zbatica, biomasa dhe biogazi;
- c) sasinë e prodhuar të energjisë elektrike që i atribuohet pjesës së biodegradueshme të mbetjeve urbane dhe industriale të cilat digjen brenda centraleve termike;
- d) sasinë e prodhimit të energjisë elektrike që i atribuohet burimeve të rinovueshme që digjen në centrale hibride, kur energjia elektrike e prodhuar, e cila i atribuohet burimeve jo të rinovueshme, nuk kapërcen 5% të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike të prodhuar;
- e) çdo CGJ është e barabartë me 50 MWh.

2. ERE sipas kërkesave do të lëshojë çdo vit GO për energjinë elektrike realisht të prodhuar nga impiantet, të cilat janë kualifikuar dhe vetëm në rastet se impianti është në punë. GO lëshohet për të njëjtat kategori prodhimi të përmendura më lart për CGJ.

3. ERE do të lëshojë CGJ për një periudhë 12-vjeçare.

4. Sasia e energjisë, për të cilën mund të lëshohet CGJ dhe/ose GO, do të matet ose llogaritet nga matjet. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente të përshtatshme të certifikuara nga autoritetet publike kompetente.

Neni 11

Ndryshime në detajet teknike të regjistruara

1. Prodhuesi duhet të informojë ERE-n për çdo modifikim të ndodhur në centralet prodhuese të energjisë së kualifikuar në përputhje me këtë rregullore.

2. Në rastet e centraleve në ndërtim, qëllimi i komunikimit të sipërpërmendur është të monitorojë realizimin e impiantit dhe të krahasojë karakteristikat finale teknike të tij me ato të komunikuar fillimisht së bashku me kërkesën për kualifikim.

3. Për impiantet e kualifikuara ende në fazë projekti, menjëherë pas vënies në punë të impiantit, prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s:

a) çdo modifikim të mundshëm të detajeve teknike lidhur me projektin (p.sh. ndryshime të fuqisë së instaluar, lloji i mbetjeve të përdorura etj.), fillimin e punës në rast të një ndërtimi të ri dhe datën e kolaudimit;

b) datën e fillimit të operimit për llogaritjen e periudhës së marrjes së CGJ-së.

4. Në veçanti, komunikimi në lidhje me datën e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik duhet të certifikohet nëpërmjet aktit të kolaudimit të mbajtur në bazë të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", sipas praktikave dhe rregullave të lidhjes në sistemin elektroenergjetik dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

5. Në rast se modifikimi i përshkruar e bën projektin jo të përputhshëm me legjislacionin, kualifikimi me vendim të Bordit do të anulohet.

Neni 12

Komunikim plotësues për kualifikimin e impianteve prodhuese termike

1. Në rastet kur prodhuesi kërkon GO dhe/ose CGJ vjetore për impiante termike prodhuese (jo hibrid) të ushqyer nga biomasa dhe biogazi, duhet të konfirmojë llojin e lëndës djegëse të përdorur.

2. Çdo modifikim i ndodhur duhet të komunikohet menjëherë nga prodhuesi për ERE-n, e cila do të procedojë në përputhje me legjislacionin në fuqi me verifikimin e të gjitha kërkesave të nevojshme për impiantet për të vijuar me marrjen e GO dhe/ose CGJ.

3. Nëse nuk jepet informacion ose jepet jo i vërtetë e drejta për të marrë GO dhe CGJ humbet për të gjithë prodhimin dhe për të gjithë pjesën e mbetur të periudhës.

4. Kur një prodhues termik (i ushqyer nga mbetjet, biomasa ose biogazi) përdor një lëndë djegëse konvencionale bashkë me burime të rinovueshme ose burime të tjera të pranuar, prodhuesi, kur të kërkojë GO dhe/ose CGJ, duhet të demonstrojë që sasia e energjisë elektrike e prodhuar, e cila i atribuohet lëndëve djegëse, si qymyri, nafta etj., është më e vogël se 5% e prodhimit total.

5. Me këtë qëllim, prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s çdo vit një vlerësim teknik të prodhimit neto të energjisë elektrike e cila i atribuohet lëndëve djegëse konvencionale të përdorura.

Neni 13

Afatet kohore kufi të aplikueshme

1. Në rastin e impianteve prodhuese të kualifikuara dhe ende jo në operim, kualifikimi do të anulohet nëse prodhuesi nuk i komunikon ERE-s:

a) fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda 18 muajve nga data e kualifikimit;

b) fillimin e punës në paralel me rrjetin elektrik brenda 3 vjetëve nga data e kualifikimit.

2. Në të dyja rastet, prodhuesi do të paraqesë një kërkesë të re për t'u kualifikuar sipas procedurave të kësaj rregulloreje.

3. Prodhuesi mund të vonojë paraqitjen e kërkesës për CGJ deri në 18 muaj nga data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik. Në rast se prodhuesi nuk paraqet kërkesën për CGJ pas vonës së lejuar (18 muaj), periudha 12-vjeçare e aplikimit të CGJ do të fillojë të llogaritet nga muaji i 18 e në vijim.

Neni 14

Llogaritja e energjisë

1. Paragrafët në vijim përshkruajnë llogaritjen e energjisë neto E_{cv} , që përfiton GO dhe/ose CGJ. Energjia e llogaritur nga prodhuesit duhet të jetë në përputhje me tipin e prodhuesit të energjisë dhe të dhënat teknike të përshtatshme. ERE ka të drejtë të verifikojë dhe t'i paraqesë prodhuesit një vlerësim të ndryshëm të energjisë.

2. Prodhimi neto i një prodhuesi energjie është prodhimi bruto, duke zbritur energjinë e marrë për nevojat vetjake dhe humbjet në transformatorët në gjenerim.

3. E gjithë energjia neto, faktikisht e prodhuar nga një prodhues i ri energjie i ushqyer plotësisht nga burime energjie të rinovueshme, përfiton nga GO dhe/ose CGJ.

4. Në rastet e prodhuesve të rinj hibrid, përfiton GO dhe/ose CGJ vetëm pjesa e energjisë që i atribuohet burimeve të rinovueshme.

Pjesa e prodhimit të energjisë elektrike neto mund të llogaritet si në vijim:

$$E_{cvi} = W_{Ren} \times \frac{P_{ci}}{\eta}$$

ku:

E_{cvi} është pjesa e energjisë elektrike neto (kWh) që përfiton GO dhe/ose CG

W_{Ren} është pesha e burimeve të rinovueshme të energjisë (kg)

P_{ci} vlera neto kalorifike (kJ/kg)

η norma mesatare e ngrohjes (kJ/kWh)

Llogaritja e mësipërme aplikohet vetëm në rastet kur energjia elektrike, që i atribuohet burimeve jo të rinovueshme, është më tepër se 5% e totalit.

5. Pjesa e energjisë elektrike, që i atribuohet rezervave të pompimit, nuk përfiton GO dhe/ose CGJ.

Pjesa e prodhimit të energjisë neto që përfiton nga GO dhe/ose CGJ për rastin e centraleve me rezerva pompimi mund të llogaritet si vijon:

$$E_{cv} = E_g - [(E_p \times \alpha)] - E_{AU}$$

ku:

E_{cv} , pjesa e energjisë elektrike neto (kWh) që përfiton GO dhe/ose CG

E_g , energjia totale neto e prodhuar (kWh)

E_{AU} , energjia që marrin stacionet ndihmëse dhe humbjet në transformatorët e gjenerimit (kWh)

E_p energjia e harxhuar nga sistemi i pompimit (kWh)

α efiçenca totale lidhur me pompimin dhe përdorimin në vazhdim të ujit të pompuar. Vlera e këtij koeficienti për kryerjen e llogaritjeve do të pranohet 0.6-0.7

Neni 15

Inspektimet teknike

ERE, në mënyrë periodike, kryen inspektime në vend në prodhuesit e energjisë për të verifikuar informacionin e dhënë.

Në rastet e deklarimit jo të vërtetë, kualifikimi anulohet dhe çdo e drejtë e lidhur me këtë humbet.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Amendamente të rregullores

1. Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të

ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare.